# DËSHMI ARKIVI

**A-421807**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Manipulohet videoja e vitit 2020, rrejshëm shfaqet Hashim Thaçi duke e qortuar Prindon Sadriun |
| ADRESA | `https://kallxo.com/krypometer/manipulohet-videoja-e-vitit-2020-rrejshem-shfaqet-hashim-thaci-duke-e-qortuar-prindon-sadriun/` |
| BURIMI | kallxo.com |
| GJENDJA | unreachable |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 03:13:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 31 gusht 2026, 19:16:32 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e66f0910f6bd104afe59b9f484ea4f488ec84b5c30c3d5de7da9dcdb10d15657` |
| TEKSTI | `ca37d7af8106dd8de9018140f7ea5850662b5bf55e121530de5e653bd5913248` |
| PAMJA | `26fa1fe3965d2c5d80f807b2a372f8875d693e549f75358cc307c58a11a2db16` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1be2853fb68473d4fba77c46440ef347109c91d2bfae7a89cd022f5cf9d81782` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c73b9db3b820e04b50f750a03f22fa10ff4921dd00c9878ab3e6c4922c61ec25` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1be2853fb68473d4fba77c46440ef347109c91d2bfae7a89cd022f5cf9d81782`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

notification icon

Kliko PO dhe abonohu për lajmet dhe hulumtimet kryesore të ditës

JO PO



**Redaktuar nga Visar Prebreza, shkruar nga Luljeta Beselica**

31.8.2026 - 21:16

# Manipulohet videoja e vitit 2020, rrejshëm shfaqet Hashim Thaçi duke e qortuar Prindon Sadriun

**Redaktuar nga Visar Prebreza, shkruar nga Luljeta Beselica**

31.8.2026 - 21:16



**Deklarata**

Thaçi, duke bërë me gisht në drejtim të bashkëshortit të ish presidentes, Vjosa Osmani në formë të qortimit

faqet në Facebook

**Vlerësimi**

**Rrejshëm**

Është manipuluar videoja në të cilën ish Presidenti i Republikëssë Kosovës shfaqet duke e qortuar ish zotëriun e parë, Prindon Sadriu. Videoja përfshin edhe Albin Kurtin e bashkëshorten e tij, por lëvizjet e trupit dhe mimikat e Thaçit tregojnë përdorimin e inteligjencës artificiale për manipulim të videos. Sipas Wasitai, videoja është gjeneruar përmes inteligjencës artificiale duke shfrytëzuar një fotografi origjinale të shkrepur më 17.02.2020, gjatë pritjes shtetërore për 12-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Kjo video është publikuar vetëm disa javë para se Gjykata Speciale të marrë vendimin në shkallë të parë lidhur me aktakuzën ndaj Hashim Thaçit, që pritet të publikohet më 16.09.2026.

**Artikulli**

Një profil në Facebook (arkiva, arkiva) ka publikuar një video të ish presidentit Hashim Thaçi, duke bërë me gisht në drejtim të bashkëshortit të ish presidentes, Vjosa Osmani në formë të qortimit.

Në këtë video shihen kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ish Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani dhe bashkëshorti i saj, Prindon Sadriu.

Videoja ka elemente që tregojnë se është manipuluar përmes Inteligjencës Artificiale, siç janë ndryshimi i mimikave të ish Presidentit Thaçi, por edhe lëvizjet e trupit të tij, prandaj Krypometër e ka testuar atë në Wasitai, platformë për detektimin e imazheve të gjeneruara përmes Inteligjencës Artificiale.

Rezultatet e Wasitai tregojnë se videoja është krijuar përmes Inteligjencës Artificiale (arkiva).

Tutje, është kërkuar fotografia në Google Lens për të gjetur imazhin që është përdorë për të krijuar këtë video dhe Krypometër ka gjetur fotografinë origjinale, e cila ishte shkrepur më 17.02.2020.

Në ceremoninë e pritjes të organizuar nga Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi me rastin e 12 vjetorit të ditës së pavarësisë, kishte qenë prezent edhe kryeministri i vendit, Albin Kurti me kabinetin e tij qeverisës.

Në këtë ceremoni raportohej se për herë të parë u përshëndeten Thaçi e Kurti.

Në fund të këtij viti, më 05.11.2020, Hashim Thaçi kishte dhënë dorëheqje nga pozita e Presidentit të Kosovës pasi atij iu konfirmua aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë.

Pas njoftimit për ngritjen e aktakuzës nga ana e Speciales në qershor të këtij viti, Thaçi ishte zotuar se do të jap dorëheqje nëse aktakuza ndaj tij konfirmohet.

“Ashtu siç kam premtuar, nuk do të lejoj që para gjyqit të dal presidenti. Unë sot jap dorëheqje nga pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës. Ftoj forcat politike të dëshmojnë maturinë që kërkon koha dhe të mos lejojnë të thellohemi në krizë kushtetuese e institucionale.”- kishte thënë presidenti Thaçi.

**Lajme**

- Rajon
- Botë

**Gjatë**

- Analizë
- Hulumtim
- Intervistë
- Mendime
- Profil
- Reportazh

**Ligji**

- Policia
- Prokuroria
- Gjykata
- Gjykata Speciale

**Krypometër**

- E vërtetë
- Pjesërisht e vërtetë
- Me kos
- Rrenë
- Rrenë e kryptë
- Qëndrim i ndërruar
- Hetimet vazhdojnë

**Shëndeti**

**... në Hagë**

Gjykimi në Hagë

Hashim Thaçi ka qenë shef i Drejtorisë Politike dhe të Informimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe udhëheqës i delegacionit të Kosovës në konferencën e Rambujesë. Pas luftës, ai kishte hyrë në politikë dhe ishte zgjedhur dy herë kryeministër i Republikës së Kosovës e më pas edhe president i Republikës së Kosovës.

Mandatin e presidentit, Thaçi e kishte dorëzuar para kohe, pasi i ishte ngritur një aktakuzë nga Gjykata Speciale.

Aktakuza ndaj Thaçit dhe të tjerëve është dorëzuar më 27.02.2023. Për të gjitha këto akuza, Hashim Thaçi dhe të akuzuarit e tjerë janë deklaruar të pafajshëm, duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e Prokurorisë.

Gjykimi që kishte filluar në vitin 2023 u përmbyll më 18.02.2026, kur gjykatësi Smith III mbylli çështjen gjyqësore në Hagë, pasi u dëgjua fjala përfundimtare e ish krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Katërshja e UÇK dha edhe një herë deklaratat e saj përfundimtare, duke u deklaruar të pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës së ngritur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

Pas kësaj faze, çështja do t'i kalojë trupit gjykues, i cili ka afat ligjor deri në tre muaj për të shpallur vendimin. Ky trup gjykues ka vendosur që aktgjykimi të shpallet më 16.09.2026.

Ish presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është në paraburgim në Hagë që nga viti 2020, kur ndaj tij ishte ngritur aktakuzë për krime lufte.

Aktakuza ndaj Thaçit dhe të tjerëve është dorëzuar më 27.02.2023. Për të gjitha këto akuza, Hashim Thaçi dhe të akuzuarit e tjerë janë deklaruar të pafajshëm, duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e Prokurorisë.

Gjykimi që kishte filluar në vitin 2023 u përmbyll më 18.02.2026, kur gjykatësi Smith III mbylli çështjen gjyqësore në Hagë, pasi u dëgjua fjala përfundimtare e ish krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Katërshja e UÇK dha edhe një herë deklaratat e saj përfundimtare, duke u deklaruar të pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës së ngritur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

Pas kësaj faze, çështja do t'i kalojë trupit gjykues, i cili ka afat ligjor deri në tre muaj për të shpallur vendimin. Ky trup gjykues ka vendosur që aktgjykimi të shpallet më 16.09.2026.

Grupi 'Liria ka Emër', ka paralajmëruar tubim më 12.10.2026 për lirimin e krerëve të UÇK.

Në kuadër të kësaj nisme nga 22.08.2026 ka nisur numërimi mbrapsht në Prishtinë dhe në komunat e Kosovës deri më 16.09.2026, kur pritet të shpallet aktgjykimi ndaj ish drejtuesve të UÇK.

Verifikimi i fakteve

- Facebook Share

Shpërndaje

- Twitter Share

Cicëroje

Të Fundit

## Punime në rrjet, KEDS tregon se ku do të ketë ndërprerje të rrymës të hënën

KEDS
06.9.2026

## Gjendet pa shenja jete një 62- vjeçar në Mitrovicë

avni zahiti

## Ferizaj, 7-vjeçari goditet nga vetura, drejtuesi i automjetit largohet nga vendi i ngjarjes

aksident me të lënduar

## Dy të arrestuarit për sulm ndaj kapitenit të Njësive Speciale, Besart Ahmetit, janë djem të një polici të Kosovës

Arrestimi

**Kryesore**

### Si ia ngatërroi klinika private rezultatet e ekzaminimit një pacienti nga Podujeva dhe e shpalli me kancer?

aloka
06.9.2026

### Hulumtim: Përpjekja për korruptimin e prokurorit në Malishevë

Korrupsioni

### Çfarë moti do të mbretërojë në Kosovë në javën e dytë të shtatorit?

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

### 27-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, Kurti: Kosova është e sigurt si asnjëherë më parë

Albin Kurti

### Dy të arrestuarit për sulm ndaj kapitenit të Njësive Speciale, Besart Ahmetit, janë djem të një polici të Kosovës

Arrestimi

**Të ngjashme**

### Si ia ngatërroi klinika private rezultatet e ekzaminimit një pacienti nga Podujeva dhe e shpalli me kancer?

aloka

### 27-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, Kurti: Kosova është e sigurt si asnjëherë më parë

Albin Kurti

### Hulumtim: Përpjekja për korruptimin e prokurorit në Malishevë

Korrupsioni

### Presidenti ukrainas pret emisarët amerikanë që u takuan me Putinin në Moskë

lufta në Ukrainë

### Çfarë moti do të mbretërojë në Kosovë në javën e dytë të shtatorit?

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

### Shkodër, arrestohet i dyshuari për disa raste të vjedhjeve

lende narkotike

**Rreth temës**

### Satelitët e Kremlinit: Portali me bazë në Krime dezinformon rreth vendimit të Gjykatës Kushtetuese për tokat në Graçanicë

FACT-CHECK

### BIRN dhe Internews Kosova publikuan raportin “Hartëzimi i dezinformatave” rreth narrativave ruse dhe serbe në media dhe rrjete sociale

Albulena Haxhiu

### Kreshnik Gashi tregon pse kandidatët për kryetar të Prishtinës nuk guxuan të vijnë në Debat Përnime (VIDEO)

debat pernime
ilustrim: Besnik Krivanjeva/Kallxo.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.